



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.03.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Klodiana Spahiu – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 13, 20 dhe 25 shkurt 2019.
2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për nxitjen e punësimit”. (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Klotilda Bushka, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla dhe Nuri Belba.

Të ftuar:

Dajna Sorensen - Zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave

Genta Prodani - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Klodiana Spahiu – Përsëritje, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Shëndetësisë.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 13, 20 dhe 25 shkurt 2019.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohen procesverbalet.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi shqyrtimin nën për nën të projektligjit “Për nxitjen e punësimit”.

Të ftuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave kemi zëvendësministren, zonjën Dajna Sorensen, dhe zonjën Genta Prodani përgjegjëse sektori.

Si fillim do të miratojmë në parim projektligjin “Për nxitjen e punësimit”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ky projektligj është diskutuar gjatë dhe ne i kemi shqyrtuar të gjitha propozimet e ardhura nga grupet e interesit. Përveç kësaj, ky projektligj është diskutuar edhe në Komisionin e Ligjeve, ku janë propozuar një sërë ndryshimesh në nene të caktuara. Ju lutem, bëni durim, sepse janë edhe një sërë propozimesh që do t’i shqyrtojmë për çdo nen që do të kalojmë.

Për të kaluar projektligjin nën për nën kemi të ftuar zëvendësministren e Ekonomisë dhe Financave, zonjën Dajna Sorensen, dhe zonjën Genta Prodani përgjegjëse sektori.

Pa humbur kohë fillojmë me nenin 1 të projektligjit, ku përcaktohet objektivi. Komisioni i Ligjeve propozon që shprehja “me legjislacion specifik” të zëvendësohet me shprehjen “nga legjislacioni i posaçëm”.

Kush është pro variantit të ardhur nga Komisioni i Ligjeve? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Qëllimi”.

Kush është pro variantit të ardhur nga qeveria? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Përkufizime”. Këtu kemi disa propozime të ardhura nga shoqata “Invalidët e punës” dhe nga Komisioni i Ligjeve.

Komisioni i Ligjeve në pikën 4 të këtij neni propozon që përpara shprehjes “legjislacionit në fuqi” të shtohet shprehja “...Kodit të Punës dhe...” dhe fjalët “persona të tjerë” të zëvendësohen me fjalën “punëkërkues”.

Kush është pro këtij ndryshimi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Komisioni i Ligjeve sugjeron që pika 13 e nenit 3 të riformulohet: “Shërbimet e punësimit janë shërbime, të cilat synojnë të informojnë, të këshillojnë, të orientojnë dhe të ndërmjetësojnë punësimin sa më të shpejtë të punëkërkuesve dhe punëkërkuesve të papunë të regjistruar nëpërmjet ndihmës së shënjestruar dhe të zhvillojnë konkurrueshmërinë në tregun e punës”.

Kush është pro këtij ndryshimi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Komisioni i Ligjeve sugjeron që të riformulohet pika 14 e nenit 3 si më poshtë: “Aftësimi dhe rehabilitimi për punë për personat me aftësi të kufizuara janë shërbimet mbështetëse dhe asistencë për vlerësimin e aftësisë për punë të personit me aftësi të kufizuara, të cilat ofrohen nëpërmjet: informimit, këshillimit profesional, vlerësimit të aftësive profesionale dhe gjetjes së punës; vlerësimit të mundësisë për aftësim dhe hartimit të programeve përkatëse; aftësimit profesional, kualifikimit plotësues, rikualifikimit me programet e mbajtjes dhe përmirësimit të aftësive të punës deri në momentin e punësimit”.

Kush është pro këtij ndryshimi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Komisioni i Ligjeve sugjeron që të riformulohet pika 15 e nenit 3, si më poshtë: “Përshtatje e arsyeshme ka të njëjtin kuptim me atë që parashikohet në legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

Kush është pro këtij ndryshimi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Gjithashtu, Komisioni i Ligjeve sugjeron që të riformulohet pika 17 e nenit 3, si më poshtë:

Germa “a” të riformulohet si vijon: “Individët me statusin e jetimit që ndodhen në kushte të vështira ekonomike”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Germa “dh” të riformulohet: “Persona që kanë vuajtur dënimin me burgim apo ndaj të cilëve është vendosur pezullimi i vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me një dënim alternativ”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në fund të germës “g” të shtohet shprehja: “Sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Germa “h” me qëllim që të sigurohet përputhshmëria me Konventën e Këshillit të Europës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, të riformulohet: “Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit”. Pas germës “h” shtohen germa “i” dhe “j” me këtë përmbajtje: Germa “i”: “Viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje” dhe germa “j”: “Nënat nën moshën 18 vjeç”.

Po, zonja zëvendësministre?

Dajna Sorensen – Faktikisht, bazuar edhe në komentet që kanë ardhur nga grupet e interesit, do të donim të kishim edhe një riformulim të germës “c”, ku flitet për personat me aftësi të kufizuara. Pra, germa “c” të riformulohet si vijon: “Personat me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë, dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga KMCAF-të”.

Klodiana Spahiu - Kush është dakord me variantin për riformulimin e germës “c”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Dajna Sorensen – Gjithashtu do të donim që të shtonim edhe një germë të fundit pas germës “j”. Pra, të njihnim edhe faktin që prindërit e personave me aftësi të kufizuara, konkretisht fëmijëve me aftësi të kufizuara të kenë një vulnerabilitet të shtuar në tregun e punës dhe të parashikojmë programe konkrete, duke i konsideruar ata si një grup i veçantë. Domethënë, të shtojmë germën “k”: “Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara”.

Atëherë, hedhim në votim edhe shtimin e germës “k” për të favorizuar prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Pra, shtohet një germë në nenin 17 “Grupet e veçanta”.

Hedhim në votë nenin 3 në tërësi.

Kush është dakord me nenin 3 me të gjitha ndryshimet e bëra? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 4 “Përfituesit”.

Në nenin 4, pika 5, kemi një propozim të ardhur nga Komisioni i Ligjeve, ku thuhet se pikat 1 dhe 2 të bashkohen në një paragraf të vetëm me këtë përmbajtje: “Çdo punëkërkuar dhe punëdhënësi i regjistruar në strukturën rajonale/vendore përfiton nga shërbimet që ofrohen nga kjo strukturë.”

Kush pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në fund të pikës 3 të shtohet shprehja “në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt”.

Kush pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Po, zonja Sorensen.

Dajna Sorensen - Lidhur me pikën 4, bazuar edhe në rekomandimet që kanë ardhur nga Komisioneri, ne do të donim të shtonim edhe një fjalë, duke e riformuluar: “Të drejtën e përfitimit të këtyre shërbimeve e kanë edhe të huajt, të cilët kanë përfituar statusin e refugjatit, si dhe azilkërkuar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt”.

Klodiana Spahiu – I njëjti rekomandim vjen edhe nga Komisioni i Ligjeve, megjithatë, në përshtatje me legjislacionin në fuqi, ne do ta hedhim në votim këtë variant të fundit të qeverisë.

Kush pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, hedhim në votim nenin 4 “Përfituesit” në tërësi.

Kush pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në kreun II “Politikat publike të punësimit”.

Neni 5 “Kompetencat e ministrisë në lidhje me politikat e punësimit”.

Komisioni i Ligjeve lidhur me këtë nen ka sjellë një sërë propozimesh.

Pika 1 të hiqet dhe të shtohet si paragraf i veçantë në nenin 3, që parashikon përkufizimet e termave që përdoren në këtë projektligj.

Fjalja hyrëse e pikës 2 të riformulohet me këtë përmbajtje: “Ministria, në lidhje me politikat e punësimit, ushtron këto kompetenca:”

Në pikën 2 germa “a” të riformulohet si vijon: “Analizon periodikisht tendencat e tregut të punës dhe parashikon zhvillimet e tij”.

Duke qenë se funksioni më i rëndësishëm i një ministrie është ai politikbërës, sugjerohet që në pikën 2, pas germës “a”, të shtohet germa “a/1”, si më poshtë: “Harton politika të reja për rritjen e punësimit dhe uljen e papunësisë”.

Në pikën 2 germa “ç”, pas shprehjes “...në Republikën e Shqipërisë” shtohet togfjalëshi “...sipas legjislacionit në fuqi për të huajt...”.

Në fund të pikës 3 të shtohet shprehja: “...që ngrihet sipas parashikimeve të këtij ligji dhe strukturave rajonale vendore në varësi të saj”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë, hedhim në votim nenin 5, me të gjitha propozimet e Komisionit të Ligjeve.

Kush pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në kreun III “Programet aktive të tregut të punës”.

Neni 6 “Programet aktive të tregut të punës”.

Kush është pro variantit të sjellë nga qeveria me pikat 1 dhe 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 7 “Shërbimet e punësimit”.

Komisioni i Ligjeve ka propozuar një ndryshim lidhur me pikën 1, germa “a”, të këtij neni si vijon: togfjalëshi “...dhe personat e interesuar...” të zëvendësohet me togfjalëshin “...dhe për çdo person të interesuar...”.

Në pikën 3 fjala “për ofrimin” të zëvendësohet me fjalët “për të siguruar” dhe fjala “fizike” të hiqet.

Kush është pro me propozimet e ardhura nga Komisioni i Ligjeve për nenin 7?

Dajna Sorensen – Faktikisht ne kemi edhe një koment të ardhur nga organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”, ku kërkojnë që pas nenit 7, në pikën 4, në fund të rreshtit të parë, pas fjalës “private”, të shtohet togfjalëshi “organizata të shoqërisë civile”. Ne jemi dakord me këtë sugjerim dhe formulimi është si vijon: “Ministria, në bashkëpunim me aktorë të tjerë publikë, privatë apo organizata të shoqërisë civile...”.

Klodiana Spahiu – Atëherë, ne jemi dakord për shtimin që i bëhet pikës 4 të nenit 7, së bashku propozimin e ardhur nga shoqëria civile.

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë, kush është pro këtij varianti? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 8 “Informimi i punëkërkuesve dhe punëdhënësve”. Këtu kemi propozimet që kanë ardhur nga shoqëria civile ose nga të gjitha grupet e interesit lidhur me këtë nen.

Dajna Sorensen – Nga të gjitha komentet e ardhura ne vlerësojmë se mund ta reflektojmë në këtë projektligj rekomandimin e ardhur nga Qendra për të Drejtat në Punë (CLR). Në nenin 1, germën “a”: “...në tregun kombëtar dhe lokal të punës” mund të shtohet edhe fjala “rajonal”.

Klodiana Spahiu – Ne jemi dakord me propozimin e CLR-së. Gjithashtu, lidhur me këtë nen në pikën 2, ku thuhet: “Informacioni ofrohet në forma dhe formate që janë të arritshme e të kuptueshme për punëkërkuesit e papunë me aftësi të kufizuara” ka ardhur edhe një propozim nga PAK-u, ku propozohet që të shtohet fjalia: “Informacioni të ofrohet edhe në gjuhën e shenjave shqipe”. Unë mendoj se ky propozim është shumë i drejtë.

Dajna Sorensen – Faktikisht ne këtë e kemi konsideruar edhe rekomandim. Gjithashtu, menduam që për të gjitha grupet në nevojë materiali duhet të jetë detyrues i përshtatur dhe të riformulohet: “Informacioni ofrohet në forma dhe formate që janë të arritshme e të kuptueshme për punëkërkuesit e papunë, sipas nenit 3, pika 17, germa “c”, me aftësi të kufizuara”. Këtu përfshihen edhe invalidët e punës, personat që nuk dëgjojnë e të tjerë.

Klodiana Spahiu – Kemi edhe një propozim të ardhur nga organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”, ku pas nenit 8, pika 2, të shtohet fjalia në vazhdim: “Strukturat rajonale/vendore të punësimit, përgatisin paketa të gatshme informuese për punëkërkuesit dhe punëdhënësit si dhe krijojnë kapacitetet e duhura për pritjen, informimin, këshillimin dhe ofrimin e ndihmës për punësim për qytetarët, në veçanti për grupet e veçanta, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 17 e këtij ligji”.

Dajna Sorensen – Unë mendoj se formulimi e përfshin edhe atë që është përmendur, megjithatë kjo të lihet në gjykimin tuaj.

Klodiana Spahiu – Atëherë, hedhim në votim nenin 8, me ndryshimin e propozuar nga Qendra për të Drejtat në Punë, i cili shton edhe tregun rajonal të punës.

Kush është pro nenit 8? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 9 “Ndërmjetësimi për punësim dhe përputhja me vendin e punës”. Lidhur me këtë nen kanë ardhur disa propozime. Nga PAK-u për nenin 9, pika 2, propozojnë: “Në rastin e një punëkërkuesi të papunë me aftësi të kufizuara, procesi i ndërmjetësimit shoqërohet me vlerësim të detajuar të punëkërkuesit, këshillim për punëdhënësit dhe të vendit e të proceseve të punës të vlefshme në tregun e hapur të punës. Proces i vlerësimit realizohet

nga një grup ekspertësh të fushës. Përbërja, organizmi dhe procedura përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit”.

Dajna Sorensen – Në lidhje me këtë mendimi ynë ka qenë që procesi i vlerësimit fillimisht do të bëhet nga strukturat e Ministrisë së Shëndetësisë, nga komisionet përkatëse dhe më tej bëhet nga specialisti i punësimit. Nuk mendojmë se ka nevojë për krijimin e grupeve specifike dhe për më tepër Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përgatitur një draft politikash pikërisht për reformimin e sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar.

Klodiana Spahiu - Atëherë, për pikën 3 të nenit 9 kemi një propozim të ardhur nga ISHPSH-ja, si vijon: “Në rast të ndërmjetësimit për punësim dhe të përputhjes me vendin e punës ky proces duhet të shoqërohet me vlerësim të detajuar edhe për kategorinë e grupeve të veçanta, si: fëmijët, gratë shtatzëna dhe nënat e reja”.

Dajna Sorensen – Për sa më sipër, ne mendojmë që zbatohen dispozitat e Kodit të Punës dhe nuk është e nevojshme që të kemi një përcaktim të tillë.

Klodiana Spahiu – Atëherë, hedhim në votim nenin 9, sipas variantit të qeverisë.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Kalojmë te neni 10, “Këshillimi dhe orientimi për karrierë, punësim dhe profesion”. Për këtë nen kemi një propozim nga Komisioni i Ligjeve ku thuhet: “Në pikën 3 të nenit 10 shkronjat “a”, “b” dhe “c”, pas fjalës “nxitësit”, sugjerohet të shtohet fjala “studentët”, si grup më vete dhe i lidhur drejtpërdrejt me nevojën për shërbim, orientim për karrierë, punësim dhe profesion”.

Propozimi i ardhur nga Komisioni i Ligjeve është edhe reflektim i propozimit që ka bërë organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”

Hedhim në votim nenin 10. Kush është pro propozimit të bërë nga Komisioni i Ligjeve për pikën 3 të nenit 10? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11, “Programet e nxitjes së punësimit”. Komisioni i Ligjeve ka bërë një propozim për riformulimin e fjalisë së dytë të pikës 3 të nenit, si vijon: “Institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësi mund të kontraktojë subjekte të tjera publike private apo organizata të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me fushën e punësimit, për të bërë të mundur zbatimin me cilësi dhe në kohë të programeve të nxitjes së punësimit”.

Kush është pro propozimit të bërë nga Komisioni i Ligjeve për pikën 3 të nenit 11?
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Për pikën 2, te programet e nxitjes së punësimit dhe kush përfshihet në këto programe, ne si komision kemi menduar të kemi edhe një pikë të veçantë për subvencionimin e kopshteve dhe çerdheve, për gratë që janë të punësuar si kategori të veçanta.

Kush është pro me ndryshimet? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kemi edhe një propozim të organizatës “Të ndryshëm dhe të barabartë”, që te pika 2 e këtij neni të shtohet edhe një pikë tjetër me këtë përmbajtje: “Programet për punësimin e studentëve”, që shkon me ndryshimet që bëmë pak më lart.

Dajna Sorensen – Në konceptimin e tyre, programet e nxitjes së punësimit janë të dedikuara për punëkërkuesit e regjistruar si të papunë dhe që nuk janë në gjendje të gjejnë punë vetë. Programet e punësimit mbështesin të rinjtë në përgjithësi, mbështesin të sapodiplomuarit, por jo domosdoshmërisht ata që janë duke ndjekur studimet.

Klodiana Spahiu – Jam shumë dakord me logjikën tuaj. Por edhe Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome ka kërkuar të shtohet një pikë për shërbimet mbështetëse, si, për shembull, mbështetja e prindërve me shumë fëmijë për pagesën në çerdhe dhe kopshte, të cilën ne e miratuarim.

Hedhim në votim nenin 11 me të gjitha ndryshimet e propozuara. Kush është pro?
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12, “Programet e formimit profesional”. Komisioni i Ligjeve ka bërë një propozim me qëllim harmonizimin e parashikimeve të këtij projektligji me ligjin nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional” dhe sugjerohet që pika 1 të riformulohet me këtë përmbajtje: “Formimi profesional u shërbehet si punëkërkuesve, ashtu edhe punëdhënësve. Kjo realizohet nëpërmjet kurseve të unifikuara të formimit profesional publik”.

Pika 2 sugjerohet të hiqet me qëllim harmonizimin e parashikimeve brenda dispozitës.

Pika 4 të riformulohet me këtë përmbajtje: “Punëkërkuesit e papunë përfitojnë kurse pa pagesë të formimit profesional të ofruara nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë. Punëkërkuesit e papunë, në raste të veçanta mund të përfitojnë një pagesë për pjesëmarrje në kurs. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rastet e përfitimit dhe masën e pagesës për pjesëmarrje në kurs”.

Për këtë nen kemi edhe një propozim nga “Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri”, ku thuhet: “Punëkërkesit e papunë, që marrin pjesë në programet e formimit profesional, të ofruara nga institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësitë mund të përfitojnë një pagesë për pjesëmarrje në kurs dhe për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit nga një qytet ose fshat në tjetrin kur në zonën ku banon nuk ofrohet shërbimi”.

Dajna Sorensen – Propozimi i ardhur nga “Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri” është i reflektuar në riformulimin që erdhi nga Komisioni i Ligjeve, por i vetmi element që nuk është përfshirë është pjesa e shpenzimeve të udhëtimit nga qyteti në fshat, megjithatë, këtë kosto e kemi të parashikuar në listën e elementeve që mund të subvencionohen, si te paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore e të tjera, në nenin 11 shkronja “i”, pra është e parashikuar.

Klodiana Spahiu – Te neni 11, shkronja “i”, ne thamë për çerdhet dhe kopshtet. Ne nuk e kemi miratuar, ndoshta duhet ta miratojmë.

Genta Prodani – Jo, jo, është në listë dhe ka ardhur si propozim i bërë nga Këshilli i Ministrave. Pra, është e përfshirë.

Klodiana Spahiu – Dakord është shkronja “i”, pra kërkesa e “Rrjetit të fuqizimit të grave” është e përfshirë.

(Diskutim pa mikrofon)

Po ajo është.

(Diskutim pa mikrofon)

Ilir Pendavinji – Në Korçë ka një qendër të formimit profesional, ndërsa në Ersekë nuk ka, ata duhet të subvencionohen....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam dakord nëse ka, por si mund ta përfitojnë, ky është problemi.

(Debat pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Në nenin 11 pranohet edhe propozimi i ardhur nga “Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri” për subvencionimin e shpenzimeve të udhëtimit kur në zonën ku banon nuk ofrohet shërbimi.

Këshilltarët ligjorë të kenë parasysh që në riformulimin të përfshihet edhe kjo kërkesë.

Arben Kamami – Mund të krijohet edhe problemi i tarifave të pagesës, se sa do të paguhet, sepse ekzistojnë tarifat shtetërore të linjave urbane dhe ndërrbane. Organizatat jofitimprurëse do të na kërkojnë edhe pagesa shtesë për personat me aftësi të kufizuar e të tjerë. Prandaj duhet parë mirë historia e rimbursimit të transportit, sepse kemi vuajtur me vite të tëra me historinë e dializës.

(Debat pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Pra, në pikën 4 të nenit 12 thuhet: “Punëkërkesit e papunë, të cilët marrin pjesë në programet e formimit profesional, të ofruara nga institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësitë, mund të përfitojnë një pagesë për pjesëmarrje në kurs duke përfshirë edhe koston e transportit bazuar në tarifatat shtetërore”. Këto ndryshime në pikën 4 reflektojnë edhe ndryshimin e propozuar nga “Rrjeti i fuqizimit të grave në Shqipëri”. Këshilltarët ligjorë të kenë parasysh ndryshimet.

Votojmë nenin 12 me gjithë ndryshimet e propozuara. Kush është pro nenit 12 me ndryshimet e propozuara? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në kreun e katërt, neni 13 “Programet pasive të tregut të punës”. Nga Komisioni i Ligjeve kemi një propozim me qëllim përshtatjen e titullit të dispozitës me përmbajtjen e saj referuar parashikimeve të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore, i ndryshuar” dhe sugjerohet që neni 13 të riformulohet me këtë përmbajtje: “Punëkërkesit e papunë të cilët plotësojnë kushtet për përfitimin e të ardhurave nga papunësia dhe regjistrohen në strukturën rajonale ose vendore si punëkërkes të papunë, në zbatim të legjislacionit “Për sigurimet shoqërore të Republikës së Shqipërisë”, përfitojnë nga pagesat e ardhura nga papunësia”.

(Diskutim pa mikrofon)

Po, nuk është nevoja që të paraqiten çdo muaj në këtë strukturë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi edhe një propozim që vjen nga Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome, të cilët mendojnë që paraqitja çdo muaj është e shpeshtë dhe e panevojshme. Ato sugjerojnë që kjo paraqitje të jetë një herë në tre muaj, por për këtë gjë duhet ndryshuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Dajna Sorensen – Ju kërkoj ndjesë, por është ligji për punëkërkesin që e mandaton atë që të shkojë një herë në muaj dhe jo ligji “Për sigurimet shoqërore”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Në Komisionin e Ligjeve ne kemi bërë riformulim total të nenit 13, ku është hequr koha e paraqitjes së personave. Kjo është bërë, sepse çështja e identifikimit në situatën e papunësisë nuk është një çështje që rregullohet në këtë ligj, por rregullohet në ligjin “Për sigurimet shoqërore”, prandaj ne nuk mund të vendosim afate këtu. Unë sugjeroj që riformulimin e bërë nga Komisioni i Ligjeve ta miratojmë në kuadër të tekstit integral dhe më

pas ta mbajmë shënim që, kur të vijë ligji tjetër, ta adresojmë si shqetësim. Po të vendosim afate këtu, kemi afate dhe te ligji tjetër dhe bëhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është objekt i këtij ligji.

Klodiana Spahiu – Paraqitja një herë në muaj e personave punëkërkues të papunë është e detyruar, apo jo?

Dajna Sorensen – Për punëkërkuesit ka një ligj të veçantë, ku është e detyrueshme të paraqiten që të demonstrojnë se po kërkojnë në mënyrë aktive punë.

Klodiana Spahiu – Ne biem dakord me variantin e ardhur nga Komisioni i Ligjeve. Kush është dakord me nenin 13, me riformulimin e bërë nga Komisioni i Ligjeve? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në kreun e pestë, neni 14 “Institucionet përgjegjëse për punësim dhe aftësitë” Komisioni i Ligjeve ka bërë një riformulim të nenit 14 ku thuhet: “Institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësitë është personi juridik publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive, i organizuar në nivel qendror, rajonal dhe vendor. Institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësitë ushtron kompetecat e mëposhtme: administron strukturat rajonale dhe vendore të punësimit dhe garanton nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara. Shkronja “a”.

Shkronja “b”, “Në bashkëpunim me punëdhënësit administron dhe zbaton programet e nxitjes së punësimit”.

Shkronja “c”, “Administron ofruesit publikë të arsimit profesional sipas legjislacionit në fuqi “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Shkronja “d”, “Zbaton programet e formimit profesional”.

Shkronja “e”, “I propozon ministrisë përgjegjëse për çështje punësimi dhe zhvillimit të aftësive aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e nxitjes së punësimit”.

Shkronja “f”, “Ushtron kompetecat e parashikuara nga ky ligj dhe nga ligje të tjera”.

Pika 3 e nenit 14 “Rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e institucionit përgjegjës për punësim dhe aftësitë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Hedhim në votim nenin 14 me propozimin e Komisionit të Ligjeve. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15, “Këshilli konsultativ për punësim”. Ky nen sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje: pika 1 e nenit 15 “Këshilli konsultativ për punësim është organ këshillimor, që ngrihet pranë institucionit përgjegjës për punësim dhe aftësitë me përfaqësimin e organizatave të punëdhënësve, organizatave sindikale, si dhe institucioneve shtetërore.

Pika 2, “Këshilli kryesohet nga ministri dhe përbëhet nga 11 anëtarë si më poshtë: një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat, një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsim, një përfaqësues nga inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës, një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, një përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dy përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara sindikale dhe dy përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve”.

Pika 3 “Anëtarët e këshillit emërohen me urdhër të ministrit pas propozimit nga institucionet dhe organizatat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni për një mandat 3-vjeçar”.

Pika 4 “Përzgjedhja e organizatave më të përfaqësuara sindikale dhe të punëdhënësve bëhet nga ministri sipas udhëzimit përkatës të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e organizatave më të përfaqësuara sindikale dhe të punëdhënësve”.

Pika 5 “Këshilli konsultativ për punësim ushtron kompetencat e mëposhtme: a) diskuton çështjet që lidhen me shërbimet e punësimit dhe programet e nxitjes së punësimit.

b) Nxit bashkëpunimin efektiv nëpërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave sindikale për çështje të nxitjes së punësimit.

c) Këshillon lidhur me mënyrën e përdorimit të fondit social të punësimit sipas parashikimeve të këtij ligji”.

Pika 6 e nenit 15: “Rregullat më të detajuara për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për Punësimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Ky është neni 15.

Hedhim në votë nenin 15 sipas formulimit të ardhur nga Komisioni i Ligjeve.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Të gjithë janë pro. Miratohet neni 15.

Do të doja të lexoja shkurtimisht edhe propozimet e ardhura nga grupet e interesit. Nga Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar për nenin 15, “Këshilli Konsultativ Trepalësh”; për nenin 16, “Këshilli Vendor Trepalësh” dhe për nenin 22, “Fondi Social i Punësimit”, pika 6, në lidhje me përbërjen e bordit të administrimit të fondit social,

propozojmë që pjesë përbërëse të këtyre këshillave dhe të bordit të administrimit të fondit social, të jenë edhe përfaqësues nga organizatat e PAK, që punojnë për këta persona me aftësi të kufizuar. Zëri i organizatave që përfaqësojnë direkt këtë kategori dhe që e njohin nga afër realitetin me të cilin përballen personat me aftësi të kufizuar, mendojmë se është shumë i rëndësishëm për t'u dëgjuar pranë këtyre këshillave dhe pranë bordit të administrimit të fondit social, gjë që do të ndikonte efektivisht edhe në vendimmarrjen përkatëse.

Dajna Sorensen – Në lidhje me këtë ne duhet të themi në radhë të parë, që personat me aftësi të kufizuar janë një nga grupet e shumta që përfitojnë dhe ne nuk mund të garantojmë pjesëmarrjen e të gjitha grupeve të ndryshme vulnerabël në këtë këshill. Gjithsesi, me kalimin e VKM-së për kompozimin e grupit në rastin konkret, ne do ta kemi parasysh që të ketë një përfaqësues të paktën nga shoqëria civile.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i përket bordit të administrimit të fondit social bën sens, sepse ai është një fond i dedikuar për kategorinë PAK.

Klodiana Spahiu – Atëherë, bordi i administrimit të fondit social është në një nen të veçantë, kështu që ju thoni se do të keni parasysh propozimin e tyre për të marrë pjesë në të, por pa të drejtë vote.

Ndërkohë, pjesën tjetër do ta kalojmë në nenin ...

Hedhim në votë nenin 15, sipas riformulimit të ardhur nga Komisioni i Ligjeve.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Të gjithë janë pro. Miratohet neni 15.

U propozua nga Komisioni i Ligjeve të hiqet neni 16 për Këshillin Vendor Trepalësh.

Para se ta hedhim në votim, do të doja të lexoj propozimin e ardhur nga kategoria PAK për nenin 16: “Këshilli Vendor Trepalësh përbëhet nga përfaqësues të institucioneve shtetërore, si edhe organizatave më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe të punëmarrësve. Këshilli përbëhet nga 7 anëtarë gjithsej, prej të cilëve:

- 3 anëtarë nga institucionet shtetërore, ku një anëtar është drejtori i strukturës rajonale/vendore.

- 2 anëtarë nga organizatat më të përfaqësuara të punëmarrësve.

- 2 anëtarë nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve.”

Sugjerimi i Shoqatës së Romëve dhe Egjiptianëve: “Cili është qëllimi me organizatat e punëmarrësve, sindikatat apo edhe organizatat që mbrojnë një numër të konsiderueshëm

punëmarrësish, që i përketin një kategorie apo një minoriteti të caktuar? Sugjerojmë të ketë përfaqësues edhe nga organizata të tilla, pasi do t'i jepte më tepër vlerë funksionimit të Këshillit Vendor Trepalësh.” Pra, ata sugjerojnë të jenë pjesë Këshillit Vendor Trepalësh, ndërsa ju të insistoni të ketë përfaqësues, por pa vendimmarrje, pa të drejtë vote.

Kush është pro heqjes së nenit 16?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Të gjithë janë pro. Miratohet.

Kalojmë te kreu i gjashtë, “Sistemi i informacionit për tregun e punës”.

Neni 17 bëhet neni 16. Këto rregullime do t'i bëjmë në zbardhje.

Për pikën 1 të këtij neni kemi një riformulim nga Komisioni i Ligjeve me këtë përmbajtje: “Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mbledh, përpunon dhe analizon informacion nëpërmjet sistemit të informacionit të institucioneve të varësisë ose nëpërmjet studimeve specifike apo anketimeve, që kanë të bëjnë me dinamikën dhe tendencat e tregut të punës apo të segmenteve të tij. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë raporton në ministri dhe në institucionet e tjera publike e private, që e kërkojnë një informacion të tillë.”

Ka edhe një propozim tjetër të ardhur nga BSPSH për pikën 1, të nenit 17: “Fjalja e fundit të ndryshojë dhe të bëhet si më poshtë: “Institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësi përpunon, analizon dhe raporton në ministrinë përgjegjëse mbi dinamikën dhe tendencat e tregut të punës dhe mbi këtë bazë informon institucionet e tjera publike, private, organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, si dhe institucione të tjera, që e kërkojnë këtë informim.”

Më duket se është e njëjta gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dajna Sorensen – Ky është një rekomandim që ka ardhur në mënyrë të vazhdueshme nga BSPSH. Në rastin konkret ne kemi thënë se dy janë klientët primarë të Shërbimit Kombëtar të Punësimit apo të institucionit përgjegjës për shërbimet e punësimit dhe të aftësisë. Këta janë punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe jo domosdoshmërisht organizatat. Informacioni është i hapur për këdo.

Arben Kamami – Do të vijë një ditë që do të krijohen edhe organizata që do të merren me punëmarrjen apo me punëdhënien, siç janë edhe kooperativat e punësimit. A mund t'i dalim përpara kësaj që të mos ta kufizojmë? Në Itali ka rreth 10 vjet që funksionojnë kooperativat e punësimit dhe mund të dalë kjo.

Dajna Sorensen – Kjo nuk kufizon ndarjen e informacionit ndaj asnjërës palë. Kjo nuk identifikon grupet e tjera. Edhe punëdhënësit, edhe punëmarrësit janë dy kategori, të cilat mund të marrin informacione në lidhje me tregun e punës. Kjo nuk përjashton askënd.

Klodiana Spahiu – Hedhim në votë nenin 17, që bëhet neni 16, sipas riformulimit të pikës 1 të ardhur nga Komisioni i Ligjeve.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Të gjithë janë pro. Miratohet.

Kalojmë te neni 18, që bëhet neni 17, “Mbledhja e të dhënave, shpërndarja dhe bashkëpunimi me institucione të tjera”.

Për këtë nen kemi përsëri një riformulim të ardhur nga Komisioni i Ligjeve: Titulli i nenit 18 të ndryshohet: “Mbledhja, shpërndarja e të dhënave dhe bashkëpunimi me institucione të tjera”.

Në pikat 1 dhe 2 fjala “INSTAT” të zëvendësohet me fjalët «institucioni përgjegjës për statistikat zyrtare».

Pika 3 sugjerohet të riformulohet si më poshtë: “Çdo institucion i administratës publike ka detyrimin e dhënies së informacionit, të kërkuar nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, për qëllimet e zbatimit të këtij ligji, në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe ka të drejtën të kërkojnë e të marrin informacion prej saj.”

Pas pikës 3 sugjerohet të shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “Ruajtja dhe përpunimi i informacionit, që shkëmbehet sipas parashikimeve të pikës 3 të këtij neni, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Këto janë propozimet e ardhura nga Komisioni i Ligjeve për këtë nen.

Hedhim në votë nenin 18, sipas riformulimit të ardhur nga Komisioni i Ligjeve.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Të gjithë janë pro. Miratohet.

Kalojmë te kreu i shtatë, “Bashkëpunimi me punëdhënësit”. Neni 19, “Të drejtat e punëdhënësve”. Për këtë nen kemi propozimet e ardhura nga BSPSH-ja: Te kreu 7, titulli të ndryshojë dhe të bëhet: “Bashkëpunimi me punëdhënësit, organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve”. Ka edhe një propozim tjetër.

Te neni 19, pika 1, në fillim të fjalisë të shtohet: “organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, si dhe çdo punëdhënës, kanë të drejtë të informohen ...” dhe pastaj është vazhdimi i fjalisë si në tekst.

Ia jap fjalën përfaqësueses së ministrisë.

Dajna Sorensen – Mendojmë se bashkëpunimi në këtë pikë bën fjalë vetëm për punëdhënësit, për deklarimin e vendeve të punës, që ata kanë. Për sa u përket marrëdhënies mes organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, këto janë të rregulluara me Kodin e Punës dhe nuk janë pjesë e objektit të këtij ligji.

Klodiana Spahiu – Dakord, atëherë hedhim në votim variantin e ardhur KM-ja për nenin 19, “Të drejtat e punëdhënësve”.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Të gjithë janë pro. Miratohet.

Kalojmë te neni 20, “Detyrimi i punëdhënësve”. Përsëri në këtë nen ka një ndryshim nga Komisioni i Ligjeve: “Pika 1 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje: “Në rastet e fillimit të procedurave të falimentit me kërkesë të punëdhënësit, sipas legjislacionit në fuqi për falimentin, ky i fundit njofton strukturën përkatëse rajonale/vendore, jo më vonë se 20 ditë kalendarike për vendimin e gjykatës për fillimin e procedurave të falimentit.”

Pika 3 e po këtij neni të riformulohet: “3. Rregullat dhe procedurat për zbatimin e pikës 2 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Para se ta hedh në votim nenin 20, po lexoj edhe një propozim të ardhur nga BSPSH. Në fund të paragrafit të parë duhet të shtohet edhe një pike me këtë përmbajtje: “Në rast falimentimi subjektit duhet t’i kontrollohet dokumentacioni për gjithë personelin për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.” Kjo më duket e drejtë.

Dajna Sorensen – Nuk është ky institucioni që ka detyrë funksionale të bëjë kontrollin për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Për këtë është inspektorati, kështu që nuk mund të jetë ky.

Klodiana Spahiu – Atëherë, ne mund të bëjmë diçka tjetër. Në të njëjtën kohë të jetë i detyruar të kontaktojë inspektoratin, ta njoftojë që po falimenton. Inspektorati, meqë ju thoni se e ka për detyrë ta bëjë këtë punë, ta kontrollojë para se të falimentojë subjekti, nëse janë paguar apo jo sigurimet shoqërore dhe ato shëndetësore, sepse na ka ndodhur realisht që kanë thënë se i kanë paguar dhe realisht kanë falimentuar dhe nuk i kanë paguar. Ta përcaktojmë në ligj.

Dajna Sorensen – Kjo është përcaktuar në ligjet e tjera. Nuk mund të përcaktohet këtu, për më shumë, që vetë ISSH-ja si institucioni përgjegjës për këtë, ka një afat gati 3 muaj nga momenti që këto derdhje bëhen nëpërmjet tatim- taksave dhe të figurojnë tek ISSH-ja. Kështu, është e pamundur të vendoset në këtë ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo në këtë ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Dakord.

Atëherë, nuk pranohet propozimi i BSPSH-së për nenin 20, sepse me këtë merren ligjet e tjera.

Kalojmë te votimi i nenit 20 vetëm me propozimet e Komisionit të Ligjeve.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Të gjithë janë pro. Miratohet.

Kalojmë te neni 21, “Punësimi i personave me aftësi të kufizuara”. Për këtë nen kemi debatuar gjatë edhe me Komisionin e Ligjeve, edhe me ministrinë. Po lexoj së pari riformulimin e ministrisë dhe më pas do ta diskutojmë dhe do ta votojmë.

Dajna Sorensen – Për sa i përket nenit 21, pika 1 sugjerojmë të jetë: “Çdo punëdhënës, i cili punëson më shumë se 24 punonjës, duhet të punësojë një person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 17, germa “c”. Përveç sa parashikohet te pika 1 e këtij neni, çdo punëdhënës ka detyrimin të punësojë një punonjës që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 17, germa “c”, për çdo 50 punëmarrës mbi 25 të parët.

Klodiana Spahiu – Dakord me pikën 1. Kalojmë te pika 2. Ju keni një ndryshim edhe për pikën 2 të këtij neni. Kemi rënë dakord që pagën ta bëjmë 100%.

Dajna Sorensen – Atëherë, pika 2 riformulohet: “Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave me aftësi të kufizuara, sipas pikës 1, të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit, në masën e 100% të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, për çdo person me aftësi të kufizuara që ai duhet të kishte punësuar, sipas këtij neni. Procedura dhe mënyra e derdhjes së kontributit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Atëherë, përveç pikës 1 dhe 2, kemi edhe një propozim nga Komisioni i Ligjeve për pikën 3 të këtij neni: “Punëdhënësit, marrin masat e nevojshme për plotësimin e vendeve të lira të punës me persona me aftësi të kufizuara. Në rastin kur punëdhënësi nuk mund të identifikojë persona me aftësi të kufizuara, për zbatimin e detyrimit sipas pikës 1 të këtij neni, paraqet kërkesë pranë strukturës përkatëse rajonale/vendore, e cila vë në dispozicion listën e punëkërkuesve të papunë, të regjistruar për këtë kategori. Për qëllime të zbatimit të kësaj pike, struktura rajonale/vendore, ndërmjetëson lidhur me përputhjen e vendit të punës me mundësitë e personave me aftësi të kufizuara.”

Pika 4 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje: “Punëdhënësit, publikë dhe privatë, mund të punësojnë në një njësi prodhimi, një numër më të madh punonjësish me aftësi

të kufizuara se ajo e parashikuar sipas pikës 1 të këtij neni. Institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësim mund të lejojë kompensim të tepërcave të numrit më të vogël të punonjësve të punësuar në njësi tjetër këtij subjekti me të njëjtin rajon apo në rajone të tjera. Për shembull, nëse ka dy rrobaqepësi, e ka marrë të njëra ... Kjo ka qenë ideja?

Vazhdojmë me pikën 5, që përsëri është sugjerim i Komisionit të Ligjeve. Sugjerohet të hiqet pika 5 pasi ligji nr. 93\2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” nuk bën një ndarje të shkallës së atësisë së kufizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në pikën 3 kishim riformulimin e Komisionit të Ligjeve, në pikën 4 kemi përsëri riformulim, kurse pikën 5 vendosëm ta heqim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikën 5 të nenit 21 e hoqëm.

Pika 6.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka riformulime.

Hedhim në votim nenin 21, me ndryshimet e propozuara nga qeveria dhe nga Komisioni i Ligjeve për pikat respektive.

Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Përveç seancës dëgjimore me grupet e interesit, ku kemi marrë parasysh çdo ndryshim të kërkuar nga ta, kryesisht nga invalidët e punës dhe personat me aftësi të kufizuara, ne arritëm të përfshijmë në këtë nen edhe invalidët e punës, të cilët përcaktohen nga Komisioni i Përcaktimit të Aftësisë për Punë si të aftë për punë të lehtë ose për punë të pjesshme. Mendoj se kjo arritje ishte dashamirësi e bashkëpunimit të përfaqësuesve të ministrisë, ministres dhe zëvendësministres, të cilat janë marrë shumë gjatë me këtë, por edhe insistimit të kolegëve të Komisionit të Ligjeve dhe të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Për këtë nen kemi debatuar gjatë, por në fund të fundit ishte një debat për të përkrahur njerëzit në nevojë, invalidët e punës, invalidët për shkak të sëmundshmërisë dhe për t’u dhënë prioritet personave me aftësi të kufizuara, të cilët, kur të dalë VKM-ja, padyshim do të kenë prioritet për t’u punësuar të parët dhe më pas invalidët e punës të aftë për punë të lehtë.

Klotilda Bushka – Dua të qartësoj që kur themi “miratojmë versionet e neneve sipas tekstit të paraqitur në projektligj nga qeveria me ndryshimet përkatëse” (u referohem

ndryshimeve që paraqiti zëvendësministrja e Financave), duhet të kemi parasysh që bëhet fjalë për riformulimin e neneve përkatës, për të cilët komisioni së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave kanë rënë dakord në kuadër të diskutimit të kërkesave që kanë paraqitur grupet e interesit. Pra, kemi në një dakordësi për riformulimin e neneve. Kur ata që do të zbardhin procesverbalin të shikojnë “sipas tekstit që lexohet nga qeveria”, të kenë parasysh që teksti i ri që lexohet, që nuk përkon me tekstin e paraqitur në projektligjin fillestar, është pikërisht teksti i dakordësuar midis komisionit tonë dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave në kuadër të kërkesave të grupeve të interesit sipas dëgjësive që ka organizuar ky komision.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Faleminderit, Klotilda!

Hedhim në votim nenin 21.

Kush është pro? Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 22. Fondi Social i Punësimit.

Komisioni i Ligjeve propozon që në fund të pikës 4 të shtohet një fjali me këtë përmbajtje: “Të ardhurat e Fondit Social të Punësimit, sipas pikës 2 të këtij neni, nuk mund të përdoren për qëllime të tjera përveç atyre të parashikuara në këtë pikë”.

Ndërkohë, për nenin 22 kemi një propozim nga BSPSH-ja për ndryshim të titullit me tekst: “Fondi i Solidaritetit Social për Punësim dhe Aftësi”. Për pasojë, ky term duhet përdorur edhe në pikën 1 të këtij neni.

Qendra për të Drejtat në Punë: Duke parë urgjencën e nxitjes reale të politikave të punësimit si një problem mbarëkombëtar, sugjerojmë që në burimet e konsiderueshme dhe reale të Fondit Social të Punësimit të shtohet germa “b”. Pika 2, neni 22: “2 përqind e tejkallimit të planit (të rishikuar ose jo) të mbledhjes së taksave dhe tarifave fiskale në Republikën e Shqipërisë për vitin ushtrimor të derdhet për llogari të Fondit Social të Punësimit në buxhetin e shtetit të vitit pasardhës”. Këtu nuk ndërhyjmë dot.

BSPSH: Pika 2 e nenit 22 të ndryshojë dhe të bëhet si më poshtë: Burimet e financimit të fondit janë nga:

a) Taksa 1% mbi fondin.

b) Transferime nga tatimfitimi i ndërmarrjeve i destinuar për këtë fond.

c) Financime nga buxheti i shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sindikata e Punonjësve të Post-Telekomit të Shqipërisë: Neni 22, Fondi Social i Punësimit, duhet të shprehet qartë për masën e kontributit të buxhetit të shtetit në krijimin e fondit. Në kushtet e mungesës së sigurisë për kontribute donatorësh në momentin e krijimit të fondit (ndoshta po ky vit 2019) dhe për vitet e para të funksionimit të tij, buxheti i shtetit duhet të marrë përsipër me një kontribut të fiksuar në ligj funksionimin e tij. Për shembull, qeveria përpara disa vitesh dha 1 milion euro në vit për mbështetjen e shoqërisë civile nëpërmjet një programi shtetëror, për shkak të emergjencës së çështjes së punësimit dhe rëndësisë strategjike të saj sot dhe në të ardhmen për shoqërinë dhe ekonominë tonë. Projektligji duhet të shprehet konkretisht për kontributin e buxhetit të shtetit në krijimin dhe mbajtjen e Fondit Social të Punësimit, ndoshta me një kontribut fillestar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Genta Prodani – Në fakt, formulimet e Postës Shqiptare nuk i kishim dhe nuk i kemi diskutuar. Formulimet e tjera që kanë ardhur nga sindikata e punonjësve ...

Ne kemi thënë që mënyra e përdorimit të fondit dhe masa e fondit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në momentin që do të hartohet projektbuxheti për vitin 2020, pasi të jetë krijuar fondi, atëherë do të kemi parashikimet e nevojshme edhe nga buxheti i shtetit dhe mënyra si do të mblidhen të ardhurat nga punëdhënësit që do të derdhin kontributet për ...

Klotilda Bushka – Ashtu siç e kanë paraqitur propozimin Qendra për të Drejtat në Punë, BSPSH-ja, grupet e interesit dhe sindikata e punonjësve, në fakt, duhet marrë në konsideratë në kuadër të të gjitha veprimtarive dhe aktiviteteve që bëhen për hartimin dhe miratimin e ligjit të buxhetit të shtetit. Tani jemi në vitin 2019 dhe nëse e shkruajmë sot në ligj me përqindje të saktë, ne nuk jemi dot në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor për buxhetin e shtetit, sepse i bie që të shkruajmë në ligj çdo përqindje për çdolloj zëri financimi që duhet të mbulojë buxheti i shtetit. Kështu që, ajo duhet të eci sipas rregullave të buxhetit të shtetit, të planifikohet dhe të buxhetohet kur të vijë momenti i buxhetimit dhe i miratimit për vitin 2020. Nuk ka si të jetë përqindje, por mund të jetë një përqindje pasi mund të ketë një konsolidim të këtij lloji aktiviteti dhe të buxhetit për këtë çështje.

Klodiana Spahiu – Atëherë, kemi edhe një propozim nga PAK, që e diskutuam edhe pak më parë, në lidhje me Fondin Social të Punësimit, ku ata kërkojnë të jenë pjesë e bordit të administrimit.

Pra, Fondi Social i Punësimit, pika 6, në lidhje me përbërjen e Bordit të Administrimit të Fondit Social, propozojmë që pjesë përbërëse e këtyre këshillave dhe e bordit të administrimit të “Fondit Social” të jenë edhe përfaqësues nga organizatat e personave me aftësi

të kufizuara dhe që punojnë për personat me aftësi të kufizuara. Do ta pranojmë këtë propozim të personave me aftësi të kufizuara?

Dajna Sorensen – Do ta vendosim në momentin që do të kemi vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave për përbërjen e bordit të administrimit të fondit. Nuk është e nevojshme që të përcaktohet në ligj.

Klodiana Spahiu – Jam dakord se e shikoj pikën 6.

KREU VIII

Sanksionet.

Neni 23

Këtu kemi përsëri riformulim nga Komisioni i Ligjeve: “Shkelja e parashikimeve të pikës 2, të nenit 21, të këtij ligji, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga inspektoratit shtetëror që mbulon fushën e punës sipas përcaktimeve të bëra nga legjislacioni në fuqi për inspektimin e punës.

Klodi, ju thatë që ta kalojmë këtu edhe pikën e ...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

2. Procedurat e shqyrtimit dhe ankimit të bëhen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin e punës.

Propozime të ardhura nga organizatat e tjera për këtë nen nuk kemi.

Kështu që, e hedhim në votim ndryshimin e propozuar nga Komisioni i Ligjeve për nenin 23.

Pro? Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Sipas variantit të Komisionit të Ligjeve neni 23 është komplet i riformuluar.

Kalojmë në kreun e fundit.

Dispozitat përfundimtare.

Neni 24.

Shfuqizime.

Ligji nr. 7995, datë 20. 09. 1995 “Për nxitjen e punësimit, i ndryshuar” shfuqizohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Do të ndërrohet vendi. Neni 24 do të jetë dispozita kalimtare

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deri në momentin e krijimit të institucionit përgjegjës, funksionet e saj do t’i kryejë Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 7995/1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar”, qëndrojnë në fuqi deri në daljen e akteve të reja për atë kohë sa nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Klotilda Bushka – Te dispozita kalimtare, ku themi “deri në momentin e krijimit të institucionit përgjegjës për funksionet që do të kryejë Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, kemi sugjeruar të vëmë një afat brenda sa kohësh do të ngrihet institucioni i ri.

Nuk mund ta lëmë pa afat, sepse kjo mund të zgjasë pambarimisht.

Do të themi se institucioni i ri përgjegjës do të ngrihet brenda një afati të caktuar nga hyrja në fuqi e ligjit dhe më pas do të themi se deri sa të ngrihet institucioni i ri, funksionet do t'i kryejë Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

3 muaj?

Genta Prodani – Aktet nënligjore i kemi parashikuar brenda 6 muajve dhe një nga aktet është edhe krijimi i agjencisë.

Klotilda Bushka – Shumë e keni lënë për 6 muaj.

Genta Prodani – Është paketa e programeve të nxitjes së punësimit. Nëse fillon të zbatohet tani, në mes të vitit do të kemi një paketë tjetër.

Klotilda Bushka – Jo, aktin për krijimin e institucionit a mund ta lëmë 6 muaj?

Genta Prodani - Dakord, e veçojmë.

Klotilda Bushka – Atëherë, neni 25, pika 1, “dispozitë kalimtare” do të themi se institucioni përgjegjës krijohet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e aktit të cituar në nenin kaq, pika x, sepse ajo nuk do të krijohet pa dalë VKM-ja. E kupton? Te pika 1 do të themi: krijimi i institucionit të ri do të kryhet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e aktit të parashikuar në nenin 26, pika x.

Te neni 26, kur citojmë nenin përkatës për aktin nënligjor, do të themi 3 muaj. Për të tjerat do të lëmë afatin 6 muaj.

Në kuadër të teknikës legjislativë, ne mund ta bëjmë edhe 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani po bëjmë edhe diskutim, edhe formulim.

Klodiana Spahiu – Jo, nuk ka problem.

Në momentin e riformulimit e votojmë.

Klotilda Bushka – Riformulimi më i saktë, te dispozitat kalimtare, neni 25, do të ishte që “institucioni përgjegjës për nxitjen e punësimit do të krijohet jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji”, pika e parë.

Pika e dytë: “Deri në momentin e krijimit të institucionit përgjegjës, funksionet e saj do t’i kryejë Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Pika 2 bëhet pika 3 dhe përmbajtja nuk ndryshon.

(Mungesë incizimi.)

Ka një sugjerim nga këshilltarët e komisionit, që kur bëhen mbylljet e institucioneve aktuale dhe krijimi i institucioneve të reja, në dispozitat kalimtare duhen parashikuar edhe kalimi i bazës arkivore, buxhetet përkatëse, staf, për efekt të vazhdimësisë së institucionit. Pra, ne do të shtojmë edhe një pikë 4, ku do të parashikojmë faktin që të gjitha të drejtat, detyrimet, buxheti dhe dokumentacioni administrativ dhe financiar i Shërbimit Kombëtar të Punësimit kalojnë te institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë në momentin që ai krijohet, sepse kjo do të lehtësojë në praktikë kalimin e të gjitha funksioneve dhe detyrave nga i vjetri tek i ri. Formulimin që bëmë mund ta miratojmë, por sa të mbarojmë ne me kalimin në tërësi, staf do të bëjë zbardhjen.

Klodiana Spahiu – Ne hedhim në votë nenin 24, “Dispozitat kalimtare” me katër pikat e ripropozuara nga Komisioni i Ligjeve dhe më pas e zbardhim. Kush është pro? Të gjithë pro. Kundër? Asnjë. Abstenim? Asnjë.

Neni 25, “Shfuqizimet”.

Pra, në nenin 25, kalon neni 24, apo jo? Kush është pro? Të gjithë pro. Kundër? Asnjë. Abstenim? Asnjë.

Neni 26, “Miratimi i akteve nënligjore”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju keni sjellë ndonjë gjë, apo jo?

Isida Koka – Ne kemi rekomanduar të rishikohet shkurtimi i afatit të miratimit të akteve nënligjore, që të sigurohet zbatimi efektiv i ligjit, sepse vlerësuam që afati 6 muaj ishte shumë i gjatë, por ia lamë për vlerësim dhe vendimmarrje komisionit përgjegjës.

Klotilda Bushka - Te pika 1 e nenit 26, “Miratimi i akteve nënligjore” lëmë afatin 6-mujor nga hyrja në fuqi e këtij ligji për të gjitha nenet me përjashtim të nenit 14 ku flitet për institucioni e ri, afati i të cilit të jetë 3 muaj.

Ministri përgjegjës për Çështjet e Punësimit për nxjerrjet e akteve nënligjore në zbatim të pikës 2 të nenit 21, nëse nuk i ka të lidhura aktet që nxjerr me VKM-të sipas pikës 1, të ketë të njëjtin afat. Nëse janë të lidhura, mund të lëmë afatin 12 muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

12 muaj është në rregull.

Nuk ka lidhje me pikën 1.

I vetmi ndryshim te neni 26, “Miratimi i akteve nënligjore” është në pikën 1 vetëm sa i takon VKM-së së nenit 14 të ligjit. Afati i nxjerrjes së aktit të ketë 3 muaj, të gjitha të tjerat të jenë 6 muaj. Pika 2 ka përmbajtjen njësoj si në versionin e paraqitur nga qeveria.

Klodiana Spahiu – Hedhim në votë nenin 26, “Miratimi i akteve nënligjore”, me sugjerimin e Komisionit të Ligjeve. Kush është pro? Të gjithë pro. Kundër? Asnjë. Abstenim? Asnjë.

(Mungesë incizimi.)

Neni 27, “Hyrja në fuqi”.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Kush është pro? Të gjithë pro. Kundër? Asnjë. Abstenim? Asnjë.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Të gjithë pro. Kundër? Asnjë. Abstenim? Asnjë.

Të gjitha ndryshimet që ne miratuam sot do të kalojnë me tekst integral bashkëngjitur raportit që i shkon seancës plenare. Seancën plenare do ta zhvillojmë ditën e mërkurë.

Ju falënderoj, pavarësisht debateve të ashpra që kemi bërë! Ishte një punë...

(Mungesë incizimi.)

MBYLLET MBLEDHJA